



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:222558

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05605816

K.Dh.Shk II.nr. 188/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A, rr.Bill Klinton p.n., kundër debitorit Universiteti “Iliria”, rr. Gazmend Zajmi, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2133/22 të datës 29.09.2023, me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2133/22 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2133/22 të datës 29.09.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Universiteti “Iliria”, dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.125/22 i datës 12.08.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të ligjit për procedurën përmbartimore si dhe për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjës faktike, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të

bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2133/22 të datës 29.09.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, ka paraqitur propozim për në bazë të dokumentit të besueshëm Ekstrakt i verifikuar nga librat afaristë me ID nr. 127501 i datës 09.08.2022, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.125/22, të datës 12.08.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri ti paguaj kreditorit borxhin prej 8.959.71 € për bartjen e mbeturinave, me kamatë prej 8% nga dita e lejimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet përmbartimore në përputhje me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014 për tarifën, shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbartuesit privat, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve monetar të cilat i ka debitori në llogarinë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, ndalimin e mjeteve në të ardhura personale ose regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar propozimin për përmbartim dhe urdhrin përmbartimor, me arsyetim se janë kontradiktor me njëri tjetrin sa i përket emërtimit të organit përmbartues ku me vulën e përmbartuesit privat është cekur Gjykata Themelore e jo siç duhet kur palët janë subjekte juridike, kompetente është Gjykata Komerciale. Shton se dokumenti në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbartimore nuk përbën dokument të besueshëm të paraparë me LPP-në. Tutje shton se referuar nenit 360 të LMD-së borxhi është i parashkruar. Po ashtu thekson se debitori nuk ka pasur marrëveshje me kreditorin, dhe se debitori ka pas marrëveshje me Kompaninë Mobile Sanitary me adresë në rr. Bulevardi Bill Clinton 10000 Prishtinë, për çka bashkëngjijt kartelën e konsumatorit nga data 30.10.2017 e deri me datë 25.06.2019. Gjykatës i propozon që të caktohet një seancë ku palët mund të paraqesin

fakte dhe prova dhe të nxjerr aktvendim me të cilin aprovohet prapësimi i debitorit, shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit dhe procedura përmbarimor përfundohet.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit në prapësim dhe duke theksuar se raporti debitor/kreditor nuk është raport kontraktual ashtu siç pretendon debitori se nuk ka marrëdhënie kontraktuale me kreditorin, duke shtuar se raporti në mes subjekteve është raport i rregulluar me norma të karakterit imperativ, pra të karakterit obligativ dhe nuk mund të ketë qasje tjetër ndaj tyre përpos ashtu siç është caktuar me këto norma, prandaj nuk është dashur të pres kontratë por ti kryej obligimet qytetare që ka ndaj kreditorit. Tutje shton se pretendimet për parashkrimin e borxhit nuk qëndrojnë sepse kërkesat reciproke nga kontratat komerciale janë të rregulluara me nenin 355 të LMD-së, ndërsa lidhur me pretendimin se debitori ka marrëveshje me një operator tjetër, atëherë gjendja faktike arsyeton të kundërtën duke bërë që debitori të bie në kundërshtim me pretendimet e tij sepse bazuar në kartelën financiare vërehet qartë se debitori ka kryer pagesa në llogari të debitorit. Gjykatës i propozon që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi dhe të aprovohet kërkesa si e bazuar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2133/22 të datës 29.09.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Universiteti “Iliria”, dhe Urdhri Përmbarimor P.nr.125/22 i datës 12.08.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isak Islami.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr. 127501, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Duke cek se pavarsisht faktit se propozimi për përmbarim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit-Kartela Financiare e Konsumatorit në kuadër të Kompanisë Rajonale të mbeturinave “Pastrimi”sh.a, gjykata gjen se dokumenti mbi të cilin mbështet propozimin për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet document I besueshëm për shkak që nuki I përmbanë tiparët e një ekstrakti nga librat afarist, me qenëse në këto dokumente nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe periudha kohorepër të ilaën kërkohet përmbushja e detyrimit nuk evidentohet saktësisht në ekstraktin nga librat afariste.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të kujdest dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Shkallës së Dytë me shikim nga shkresat e lëndës ka vërejtur se nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës 127501, rezulton se borxhi në shumën prej 8.959.71 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2017 deri me datën 30.06.2022, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2017 deri me datën 31.12.2017, me ç'rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë. Andaj, duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 27 të LPP-së, e cila në mënyrë shprehimore ka paraparë se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, kështu në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim.

Andaj, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por të njëjtat mbesin të pabazuara pasi nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje përbarimore.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.188/24 me datë 20.05.2024

Gjyqtarja,
Franciska ZhitijaYmeri